



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 100 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenin 6 i Statutit të Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR

ZGJERIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE KAPITALE

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 06/Nr.1088/2011 për zgjerim të listës së projekteve kapitale.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës dhe anëtarëve të Kuvendit të Komunës për zgjerim të listës së projekteve kapitale për vitin 2011 që janë në interes të Komunës.

III

Duke iu referuar nenit I të këtij vendimi zgjerimi i listës së projekteve kapitale që është propozuar nga ana e ekzekutivit të Komunës dhe nga anëtarët e Kuvendit të Komunës për vitin 2011 janë:

- Adoptimi i zyrave për regjistrim të gjendjes civile,
- Kanalizimi nga lagja e re – fshati Meliq,
- Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave,
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit,
- Riparimi i nyjeve sanitare nëpër shkolla,
- Vendosja e perdeve nëpër shkolla,
- Zgjerim dhe renovim i rrugës Uji i thartë –Pustenik,
- Pajisja e shkollave me inventarë,
- Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit-Gorancë,
- Asfaltimi i rrugës për lagjen Kollomoqe dhe
- Mirëmbajtja dhe sanimi i rrugëve.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 25.08.2011

